

Bëhuni anëtar!

byggnads.se/bli-medlem

Shqiptare

Albanska

Kujdesu për të
drejtat e tua
në punë



BYGGNADS

Mos lejo të të keqpërdorin!

A e dini se keni të drejta sipas ligjit dhe kontratës ose marrëveshjes kolektive? Këto të drejta kanë ardhur si rrjedhim i përpjekjeve sindikaliste për më shumë se 100 vjet.

Detyra e sindikatës Byggnads është që të sigurojë se kushtet për anëtarët tanë të jenë sa më të mira që të jetë e mundur.

Sindikata është në anën tuaj.

Kur lindin komplikime në punë, si p.sh. nëse nuk ju jepet **rroga e drejtë ose nëse nuk ju **ofrohen kushtet e drejta**, ne ju vijmë në ndihmë.**

Mirë se vini si anëtar në sindikatën Byggnads, nëse nuk keni qenë më herët!

Byggnads është sindikata për ju si punëtor ndërtimi.

Ne punojmë për *paga më të mira dhe për një ambient më të mirë pune.*

Me ne, ju merrni mbështetje, konsultime dhe siguracione.

Së bashku bëhemi më se *100 000 anëtarë* të fuqishëm, krenarë dhe të sigurt.

Sa më tepër që jemi, aq më shumë mund të punojmë për të drejtat tona. Ju nevojiteni!

Së bashku, ne do të punojmë për të siguruar që të gjithë anëtarët të kenë:

- **pagën** më të lartë të mundshme.
- **ambientin** më të mirë të mundshëm të punës
- **punësim** të sigurt
- **zhvillim** në punë

Mos pranoni në asnjë mënyrë kushte më të ulëta se ato që përfshihen në kontratën kolektive.

Me rëndësi!

- **Nuk ju pushojnë** dot nga puna vetëm që jeni bërë anëtar në sindikatë.
- **Është e drejta** e juaj ligjore për të qenë anëtar në sindikatë.
- **Nuk ka nevojë** t'i tregoni shefit ose punëdhënësit tuaj nëse nuk keni dëshirë.

Ç'është kontrata kolektive?

Kontrata kolektive është një marrëveshje midis Byggnads dhe punëdhënësve. Këtu gjenden rregullat që përjasin me pagën, orarin e punës dhe mjedisit të punës.

Kontrata kolektive nuk është diçka që vjen vetë. Jemi ne ata që e negociojme atë me punëdhënësit. Shteti nuk ndërhyr fare. Sa më tepër anëtarë të jemi, aq më të mira do të jenë kushtet të cilat do mundemi të marrim.

Nëse nuk ka kontratë kolektive?

Disa kompani nuk kanë kontratë kolektive. Në atë rast edhe rregullat nuk vlejnjë. Pyesni shefin ose punëdhënësin tuaj nëse ka ose na telefononi.

Nëse nuk ka kontratë kolektive është detyra e jonë të përpiqemi që të përpiqemi te arrijmë një marrëveshje të tillë.

Pagat

Pagat varen nga disa faktorë të ndryshëm si p.sh. ajo se nëse keni apo jo një certifikatë profesioni. Përgjithësisht vlen **rregulla e pagës së njëjtë për punën e njëjtë**, brenda ekipit të punës.

Forma primare e pagës është ajo e të paguarit për performancën, e ashtuquajtura pagë e akorduar. Ndërkaq, ju mund të paguheni edhe me rrogë për orë pune.

Një pagë mesatare në sektorin e ndërtimit është **rreth 215 SEK për orë**. Por, ju mund të fitoni më tepër ose më pak se kaq.

Telefononi Byggnads në rajonin tuaj nëse keni pyetje në lidhje me pagën tuaj.

Pagat pa çertifikatë profesioni [Kontrata e sektorit të ndërtimit]

Nëse nuk keni çertifikatë profesioni atëherë ju merrni një **përqindje të pagës së punëtorit të çertifikuar në vendin e punës:**

- **70%** nëse keni më pak se një vit përvojë
- **88%** nëse keni më shumë se një vit përvojë
- **100%** nëse keni më shumë se gjashtë vjet përvojë përkatëse profesionale

Nëse nuk ka **kontratë kolektive** atëherë nuk ka as rregulla mbi pagën dhe kjo nënkupton që rroga e **juaj mund të jetë tejet e ulët.**

Kontrata kolektive siguron

- **Kompensimin e udhëtimit:**
Me makinë: sipas nivelit të Agjencisë Suedeze të Taksave me 2,5 SEK/KM (2023)
Transporti publik: 1/20 e çmimit të kartës mujore për çdo ditë pune.
- **Kontributi për pushimin vjetor:**
13,0 - 13,2%
- **Pensioni sipas kontratës kolektive:**
5,7 - 6,2% e rrogës (punëdhënësi paguan ekstra në pensionin tuaj)
- **Reduktim i orarit të punës:**
40 orë në vit me rrogë (leje nga puna me të drejtë rroge përveç pushimit vjetor)
- Rritje vjetore e pagës.

- **Paga** e të sëmurit nga dita e dytë, nëse jeni i sëmurë (sipas ligjit).
- **Mëditje** nëse punoni dhe banoni në vend tjetër.
- **Një banim** i mirë nëse punoni dhe banoni në vend tjetër.
- **Siguracione** nëse vriteni ose aksidentoheni në punë.
- **Paga e ditëve të festave publike:** Të drejtë pushimi nga puna me pagë nëse dita e festës publike përket me një ditë pune.
- **Pushim/largim me leje:** pushim ose largim nga puna me pagë për raste të veçanta.

Llojet e punësimit

Mos bini dakord me çdo lloj punësimi.

- **Punësimi i përhershëm** është forma primare e punësimit në sektorin e ndërtimit.
- Ju mund të jeni një **punonjës në provë deri** në gjashtë muaj, për t'u punësuar më pas me kontratë pa afat.
- Në raste të caktuara ju mund të keni **një punësim me afat të kufizuar**.

VINI RE! **Çertifikata e punësimit** duhet t'ju jepet kur të keni filluar punën. Çdo muaj do të merrni **fletëlaajmërimin** e rrogës së paguar. Kur të largoheni nga puna ju do të merrni **çertifikatën e punëdhënësit**. Ruajini të gjitha këto!

Orari i punës

- Orët e zakonshme të punës: **40 orë në javë** - 8 orë në ditë.
- Ju duhet të **merrni kompesim për punë jashtë orarit nëse punoni më shumë se 40 orë** në javë.
- Ju duhet të merrni shtesë për punë në **orar të papërshtatshëm (OB)** nëse punoni mëngjese të herëshme/mbrëmjeve, netëve ose gjatë fundjavave/festave.
- Normalisht askush **nuk mund t'ju detyrojë** që të punoni jashtë orarit të punës ose gjatë natës.
- Gjatë ditës së punës ju takojnë të merrni **pushime te shkurtra**.
- Ju keni të drejtë **25 ditë pushimi** vjetor në vit.

Zgjidhja e kontratës

Ju mund të pushoheni nga puna vetëm si pasojë e mungesës së punës ose për arsye personale.

- **Kompania nuk mund të përfundojë punësimin tuaj dhe t'ju pushojë nga puna në te njëjtën ditë.** Afati i përfundimit të kontratës së punës është të paktën një muaj nëse punësimi i juaj është me kontratë pa afat ose 14 ditë nëse jeni i punësuar në provë.
- Nëse ju jeni anëtar në sindikatën Byggnads, punëdhënësi duhet fillimisht **të negociojë me ne.** Normalisht, personi i cili është punësuar i fundit duhet të largohet/hiqet i pari.
- Nëse ju vendosni që të jepni vetë dorëheqjen nga puna, afati i përfundimit të kontratës së punës është një muaj.
- Nëse ju keni një punësim në provë, ju mund të njoftoni përfundimin e kontratës dhe të lini punën në të njëjtën ditë.

Ambienti i punës dhe siguria

Punoni ose nëse shikoni dicka të rrezikshme në punë? Kërkoni kontakt me **përfaqësuesit tanë të sigurisë me helmeta jeshile.**

Nëse në vendin tuaj të punës nuk ka përfaqësues të sigurisë atëherë ju mund të na telefononi për të ardhur në kontakt me **përfaqësuesin rajonal të sigurisë.**

- Punëdhënësi duhet të sigurojë **rroba këpucë pune** dhe pajisje mbrojtëse.
- Gjithmonë duhet të ketë **ambiente të personelit** të pajisura me tualet, dush dhe vend të posaçëm për të ngrënë.
- **Asnjëherë mos pastroni asbest** dhe materiale të tjera të rrezikshme pa pajisje mbrojtëse dhe trajnimin e nevojshëm.

Bëhuni anëtar!

Nëse diçka nuk funksionon siç duhet në punë ose nëse punëdhënësi nuk zbaton rregullat e kontratës kolektive ne mund t'ju ndihmojmë, vetëm nëse jeni anëtar i sindikatës.

Bëhuni anëtar:

bygg.nu/bli-medlem

Fondi i papunësisë

Mos harroni të bëheni anëtar edhe në fondin e papunësisë. Nëse ndodh që të mbeteni pa punë, fondi i papunësisë mund t'ju paguajë deri në një nivel prej 80 përqind të pagës tuaj të mëparshme.

bygg.nu/sakakassa

Si anëtar ju ofrohet

- Këshillim, mbështetje dhe asistim në negociata.
- Mundësi për të aplikuar për ndihmë ligjore.
- Ne ju ndihmojmë të kuptoni tekstin e kontratave/marrëveshjeve të punës.
- Siguracione shtesë nëse vriteni ose aksidentoheni në punë ose nëse sëmureni.
- Trajnime të ofruara nga sindikatat për të mësuar më shumë.
- Mundësi për të ndikuar si në raport me Byggnads, ashtu edhe në vendin tuaj të punës.
- Karta e anëtarit e karikuar me beneficione/përfitime dhe zbritje çmimesh/oferta.
- Anëtarësim më i lirë në fondin e papunësisë.
- Abonim në revistën Byggnadsarbetaren.

Kontaktoni Byggnads

Çdo informacion i rëndësishëm gjendet
në **byggnads.se**

***Mbështetje dhe konsultacion
për ju si anëtar***

Qendra e Anëtarit në Byggnads

010-601 10 00

info@byggnads.se

BLI FACKLIGT MEDVETEN!
PÅFARTEN

FORCOHU ME NJË
TRAJNIM!

byggnads.se/pafarten

Së bashku jemi të fortë

Kontrata kolektive është nën sulme të vazhdueshme dhe ne luftojmë për të ruajtur të drejtat tona. Ne negociojmë me punëdhënësit për kontratën kolektive përafërsisht çdo dy vjet. Sa më tepër anëtarë të jemi, aq më të fuqishëm bëhemi në negociata.

Ju nevojiteni!

Bëhuni anëtar!

bygg.nads.se/bli-medlem